



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____ 2025

PËR “MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT 2025–2030 DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 9, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit 2025–2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe të gjitha ministrinë e institucionet përgjegjëse të përmendura në tekstin e kësaj strategjie për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi RAMA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____ 2025

PËR “MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT 2025–2030 DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 9, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit 2025–2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe të gjitha ministrinë e institucionet përgjegjëse të përmendura në tekstin e kësaj strategjie për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi RAMA

**RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
“PËR
MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR ZHVILLIMIN E
TURIZMIT 2025 - 2030 DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN
TË ARRIHEN**

Projektakti i propozuar, i cili ka si qëllim miratimin e dokumentit të Strategjisë Kombëtare të Turizmit 2025-2030, është përgatitur në vijim të dokumentit të Strategjisë Sektoriale të Turizmit 2019 – 2023, që përfundoi shtrirjen kohore të tij në vitin 2023, si dhe në funksion të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022 – 2030, pjesë e së cilës është edhe industria e turizmit.

Vizioni i Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit të Turizmit është që Shqipëria të njihet si destinacioni i ri më emocionues në Evropë, i cili ofron vlerën më të mirë të bazuar në aspektet e cilësisë, gjithëpërfshirjes dhe qëndrueshmërisë dhe do të bazohet ndër të tjera, në ruajtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore për brezat e ardhshëm, promovimin e zhvillimit të përgjegjshëm të turizmit dhe të praktikave që minimizojnë ndikimin mjedisor e që mbështesin komunitetet vendase, por njëkohësisht duke krijuar një mjedis ku vizitorë të ndryshëm të ndihen të mirëpritur, të vlerësuar dhe pjesë e komunitetit.

Objektivat që synohen, të arrihen deri në vitin 2030, nëpërmjet orientimit të politikave bazuar Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit të Turizmit, në përputhje me vizionin dhe pozicionimin e Shqipërisë, janë si më poshtë:

- ✓ Kapaciteti total i shtretërve parashikohet të rritet me një normë të përbërë rritjeje vjetore (CAGR) prej 8%, duke arritur në 477.414 shtretër brenda shtatë vitesh.
- ✓ Okupanca mesatare vjetore e shtretërve do të rritet në 34% deri në vitin 2030, ndërkohë që kohëzgjatja mesatare e qëndrimit pritët të rritet në 6,0 netë.

- ✓ Rritja e numrit të të punësuarve në industrinë e turizmit në Shqipëri në 73,778 persona.
- ✓ Numri total i studentëve në shkollat publike profesionale, si dhe i studentëve në institucionet e arsimit të lartë synohet të rritet përkatësisht në 3810 studentë.
- ✓ Totali i të ardhurave nga turizmi pritet të arrijë në 6,7 miliardë euro deri në vitin 2030.

Arritja e këtyre synimeve sasiore do të mbështetet në objektivat cilësore si: Prezantimi i produkteve dhe përvojave të reja, rritja e ndërgjegjësimit mbi markën kombëtare me qëllim forcimin e imazhit të Shqipërisë, përmirësimit të kuadrit rregullator, përmirësimit të sistemit të menaxhimit dhe marketingut të destinacioneve, shfrytëzimi strategjik i hapësirës për të nxitur zgjerimin e qëndrueshëm të turizmit etj.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim është në përputhje të plotë me programin politik të Këshillit të Ministrave për fushën e turizmit. Projektakti nuk është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve të miratuara për vitin 2025 për Ministrinë e Turizmit, pasi procedurat e hartimit dhe konsultimit të projektvendimit kanë nisur në përputhje me Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të vitit 2024.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektvendimi miraton dokumentin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit 2025-2030. Ky dokument parashikon zhvillimin e qëndrueshëm nëpërmjet një strategjie sistematike dhe të zbatuar plotësisht në të gjitha nivelet e menaxhimit të turizmit, me qëllim garantimin e zhvillimit të balancuar dhe të qëndrueshëm në aspektet ekonomike, sociale dhe mjedisore.

Sfidat aktuale me të cilat përballet turizmi, frenojnë kapacitetin e sektorit për rritje të qëndrueshme dhe përmirësim të konkurrueshmërisë. Adresimi i këtyre sfidave përmes planifikimit strategjik, investimeve në infrastrukturë, reformave rregullatore, zhvillimit të forcës punëtore, prezantimit të sistemit të informacionit për menaxhimin e turizmit dhe angazhimit të grupeve të interesit, është kritik për transformimin e sektorit të turizmit në Shqipëri gjatë viteve të ardhshme. Për realizimin e qëllimeve të sipërcituara, është hartuar i detajuar, plani i veprimit të strategjisë me aktivitetet përkatëse.

Strategjia mbështetet në gjashtë shtylla kryesore: Investimet, Politika fiskale dhe rregullatore në turizëm, Menaxhimi i destinacioneve, Zhvillimi i produktit turistik, Marketingu i destinacioneve dhe Përgatitja e profesionistëve të kualifikuar.

I është dhënë përparësi qëndrueshmërisë afatgjate duke u bazuar në një sërë nismash ku përfshihen zhvillimi i një kuadri të ri rregullator, ripërcaktimi i sistemit të menaxhimit të destinacioneve, përcaktimi i qartë i përgjegjësive dhe miratimi i metodave të reja të menaxhimit për të monitoruar treguesit e performancës në mënyrë efektive.

Në fokus të strategjisë është ndarja e vendit në gjashtë klastera turistikë, duke grupuar disa rajone sipas karakteristikave të përbashkëta. Për secilën nga klasterat, drafti ka nxjerrë produktet turistike parësore dhe dytësore, burimet dhe atraksionet kyçe, si dhe përvojat kryesore të disponueshme për turistët, të cilat renditen si vijon: Klasteri i bregdetit të Adriatikut, klasteri verior i brendshëm, klasteri i qytetit të Tiranës, klasteri qendror, klasteri i bregdetit të Jonit dhe klasteri jugor i brendshëm.

Parashikohet që sektori i turizmit të zhvillohet ndjeshëm në 7 vitet e ardhshme, me ndihmën edhe të disa instrumenteve fiskale, si dhe kredive me kushte lehtësuese për investorët. Numri i të punësuarve në turizëm pritet të arrijë në mbi 73 778 në vitin 2030 nga rreth 42 mijë që ishte vitin e kaluar, me një rritje prej 31 mijë persona ose 42.1%. Një rritje e ndjeshme pritet edhe në numrin e shtretërve, gjë që do të shoqërohet me shtim të numrit të turistëve dhe rrjedhimisht, edhe netë të qëndrimeve të tyre. Kjo jo vetëm nëpërmjet krijimit të kapaciteteve të reja akomoduese, por edhe formalizimit të njësive ekzistuese

akomoduere. Strategjia parashikon që në vitin 2030, vendi të jetë 477 mijë shtretër të regjistruar përkundrejt 270 mijë që kanë qenë vitin e kaluar. Pra, një rritje mbi 207 mijë ose 76%.

Po ashtu shtimi i investimeve, rritja e numrit të shtretërve dhe të punësuarve pritet të rrisë të ardhurat nga sektori i turizmit. Në vitin 2030, pritet të mbledhë nga turizmi 6.7 miliardë euro ose 2.6 miliardë euro më shumë sesa vitin e kaluar, që u konsiderua edhe si një ndër më të mirët në vite edhe në aspektin financiar. Përmes aplikimit të masave të parashikuar, parashikohet të ketë një rritje të numrit të shtretërve dhe diversifikim i motiveve të ardhjes në Shqipëri, duke zvogëluar me 35% numrin e netqëndrimeve gjatë pikut të sezonit veror dhe rritjen e tyre jashtë tij.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi propozohet duke u mbështetur në nenin 100 të Kushtetutës, shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 9, të ligjit nr. 93/2015 “Për Turizmin”, i ndyshuar, në të cilën përcaktohet detyrimi i ministrisë përgjegjëse për turizmin për hartimin e strategjisë së zhvillimit të turizmit dhe planin e veprimit të saj. Hartimi i kësaj strategjie është realizuar duke u mbështetur në objektivat strategjike për zhvillimin e turizmit përcaktuar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2022-2030 dhe harmonizuar me Strategjinë për Zhvillimin e Evropës Juglindore (SEE 2020), hartuar nga Këshilli për Bashkëpunimin Rajonal (RCC). Po kështu, çështjet e planifikimit, industrisë turistike dhe standardeve mbështeten tek parimet e legjislacionit ekzistues për turizmin. Për sa i takon masave zbatuese të politikave, janë marrë në konsideratë përvoja pozitive nga vendet e OECD-së etj.

Gjithashtu theksojmë se ky projektakt nuk përfshihet në kategorinë e akteve të ndaluara në kuptim të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në KQZ sipas të cilit përcaktohet se ndër veprimtaritë e ndaluara janë:

“Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re

pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi i akteve ligjore ose nënligjore, ose nxjerrja e tyre me qëllim informimin e publikut në lidhje me vendimmarrjen e institucionit miratues në faqen e tij zyrtare, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensione, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, faljet e kamatëvonesave, të gjobave, të detyrimeve tatimore e doganore, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive apo shpërblimeve, përveç kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore ose epidemisë/pandemisë, apo ka si qëllim zbatimin e një detyrimi ligjor me karakter ndërkombëtar apo zbatimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë.”

Për këtë sqarojmë se projektvendimi që po paraqesim për shqyrtim dhe miratim nuk parashikon dhënie përfitimi për kategori të caktuara të popullsisë, dhe aq më tepër nuk lidhet me: rritje page, pensionesh, mbështetje ekonomike apo sociale, ulje ose heqje të taksave, falje të kamatëvonesave, të gjobave, të detyrimeve tatimore e doganore, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënie të pasurive a të shpërblimeve.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk ka për qëllim përafrimin e legjislacionit me Acquis Communautaire.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi miraton “Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2025-2030” e cila është hartuar në tre kapituj dhe ka përmbajtjen si më poshtë:

Kapitulli I-Analiza dhe Diagnoza në të cilën jepet një panoramë e detajuar e zhvillimeve të sektorit të turizmit në Shqipëri, por edhe më gjerë. Vlerësimi i situatës është lidhur kryesisht me:

- Ofertat e turizmit

- Vlerësimin i zinxhirit të vlerës së turizmit
- Kërkesën për turizëm
- Anketat lidhur me pritshmëritë dhe hartëzimi i grupeve të interesit
- Sistemin rregullator dhe e menaxhimit të turizmit

Qasja në hartimin e këtij dokumenti strategjik për sektorin e turizmit në vend, synon të jetë gjithëpërfshirëse, duke pasur pjesë të procesit që në fazën e parë të analizës së situatës, të gjithë grupet e interesit nëpërmjet realizimit të sondazheve të ndjesisë, të dedikuara për target grupe të veçanta (publiku, sektori privat, sektori publik), intervistat me grupet e ndryshme të interesit duke u fokusuar veçanërisht në takimet konsultative me përfaqësues të donatorëve, realizimi i vizitave në terren etj., me objektivin kryesor krijimin e një dokumenti realist, të zbatueshëm për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit.

Në këtë kapitull është evidentuar progresi që Shqipëria ka bërë për sa i përket zhvillimit social dhe konkurrueshmërisë ekonomike si dhe sfidat në lidhje me uljen e papunësisë, luftën kundër korrupsionit dhe sigurimin e qëndrueshmërisë mjedisore.

Nëpërmjet këtij kapitulli është konstatuar se Shqipëria, ekonomikisht, ka bërë hapa të rëndësishëm, veçanërisht në sektorët e energjisë, turizmit dhe bujqësisë. Në vitin 2023, Shqipëria u rendit e 4-ta në nivel global për rritjen më të madhe të përqindjes së mbërritjeve të turistëve ndërkombëtarë, duke shënuar një rritje me 56% krahasuar me vitin 2019. Ndërkohë, bujqësia mbetet një komponent kyç i ekonomisë dhe sektori po modernizohet me perspektivën e rritjes si për nga produktiviteti, ashtu edhe për nga qëndrueshmëria.

Vlerësohet se turizmi ka parë një rritje të konsiderueshme, me 7,5 milionë mbërritje ndërkombëtare në vitin 2022, shifër e cila u rrit në 10,1 milionë në vitin 2023. Kjo rritje e turizmit kontribuoi në një rritje ekonomike prej gati 5% në vitin 2022. Në vitin 2023, PBB-ja e vendit me çmimet aktuale arriti në 23 miliardë dollarë, nga 12,3 miliardë dollarë në vitin 2012.

Është evidentuar kanalizimi i investimeve të rëndësishme për përmirësimin e infrastrukturës së transportit dhe energjisë, me qëllim rritjen e ndërlidhjes dhe mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit sa i përket aksesit detar dhe atij ajror.

Është konstatuar se investimet në ndërlidhje, reformat ekonomike dhe gjyqësore, bashkëpunimi me vendet fqinje dhe procesi i anëtarësimit në BE kanë rritur në mënyrë kumulative perspektivat ekonomike dhe stabilitetin e Shqipërisë në rajon, dhe kanë krijuar një mjedis të favorshëm për rritjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të turizmit.

Gjithashtu, është bërë një analizë mbi ofertën aktuale të turizmit duke e zërthyer në shifra e cila ka nxjerrë në pah një rritje të dukshme të kapaciteteve të akomodimit. Gjithashtu në këtë seksion janë evidentuar strukturat që ofrojnë qira afatshkurtër bazuar studimeve të nxjerra nga platformat e rezervimeve online.

Janë vlerësuar investimet e markave ndërkombëtare të hoteleve, në turizëm në Shqipëri, gjë që demonstroi një përkushtim domethënës ndaj ofrimit të akomodimit të cilësisë së lartë.

Vlerësimi i zinxhirit të vlerës së turizmit ka përfshirë studime parësore dhe dytësore për vlerësimin e pikave të forta dhe të dobëta të elementeve kryesore të ofertës së turizmit shqiptar. Nga studimet është vlerësuar se:

- ka një tendencë pozitive drejt përdorimit të shërbimeve dixhitale online dhe platformave të rezervimit online, por ka akoma vend për përmirësim;
- është përmirësuar ndërlidhja ajrore dhe rrugore, por ka ende nevojë për përmirësime në aksesueshmërinë e transportit publik dhe cilësinë e rrugëve, veçanërisht në zonat rurale;
- sektori i akomodimit ka pësuar rritje dhe ofron më shumë opsione, por ekziston një nevojë e dukshme për standarde më të larta të cilësisë,
- potenciali për gastro-turizëm dhe produkte të tjera të turizmit të interesit të veçantë mbetet tepër i pashfrytëzuar;
- duhet kujdes i shtuar për ruajtjen e burimeve natyrore dhe kulturore, rritjen e aksesueshmërisë, menaxhim të përpjekjeve për zhvillimin e produkteve dhe marketing efektiv.

Në seksionin “Kërkesa për turizëm” janë përfshirë një numër i konsiderueshëm treguesish sasiorë dhe cilësorë, që lidhen kryesisht me numrin e vizitorëve të huaj në Shqipëri gjatë viteve të fundit, numrin e mbërritjeve të turistëve dhe netë-qëndrimeve në hotele dhe struktura të ngjashme kontributin e turizmit në Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB) dhe punësimin, shpenzimet e turistëve në Shqipëri, numrin e vizitorëve në atraksionet kulturore të vendit,

shërbimet e akomodimit, investimet e huaja direkte etj. Këta tregues e bëjnë më të prekshme dhe më të qartë situatën e zhvillimeve të sektorit të turizmit në Shqipëri, si për sa i takon kërkesës, ashtu edhe ofertës.

Janë prezantuar të dhënat për vitin 2023, ku sektori i turizmit në Shqipëri vlerësohet se ka shfaqur një rimëkëmbje të jashtëzakonshme. Sipas të dhënave të INSTAT:

-Mbërritjet ndërkombëtare arritën në 10,2 milionë, me një rritje me 36% krahasuar me vitin 2022;

-Numri i mbërritjeve të turistëve dhe netë-qëndrimeve në hotele dhe struktura të ngjashme arriti 2,33 milionë dhe 6 milionë në vitin 2023, një rritje me mbi 48% për mbërritjet dhe mbi 56% për netë-qëndrimet, krahasuar me vitin 2022.

Konstatohet se Turizmi në Shqipëri karakterizohet nga një sezonalitet i theksuar, ku korriku dhe gushti përfaqësojnë gati 40% të totalit të mbërritjeve vjetore. Kjo tregon një nevojë të theksuar për përpjekje të mëtejshme të diversifikimit të tregut gjatë periudhave të ardhshme.

Të dhënat nga Banka e Shqipërisë tregojnë se viti 2024 shënoi një moment historik, pasi të ardhurat totale arritën një shifër rekord prej 4,1 miliardë euro.

Kjo përfaqëson një rritje mbresëlënëse me 46% krahasuar me një vit më parë, duke theksuar kontributin e konsiderueshëm të sektorit të turizmit në ekonomi.

Për sa i përket analizës së treguesve kryesorë të performancës, sektori i akomodimit në Shqipëri ka shfaqur tendenca pozitive, por mbetet nën mesataren rajonale.

Në seksionin “Anketa lidhur me pritshmëritë dhe hartëzimi i grupeve të interesit” shpjegohet se u ndërmor një studim parësor për të vlerësuar pritshmëritë në lidhje me statusin aktual dhe perspektivat e zhvillimit të turizmit. Kjo përfshiu një anketë online e cila mblodhi 1024 përgjigje të vlefshme, të shpërndara në tre segmente:

- Sektori publik (91 të anketuar);
- Sektori i biznesit (195 të anketuar);
- Publiku i gjerë (738 të anketuar).

Studimi i pritshmërive për turizmin nxjerr në pah perspektivën optimiste të grupeve të interesit për zhvillimin e mëtejshëm të turizmit në Shqipëri si dhe nevojën për përmirësime të mëtejshme të infrastrukturës, mungesën e forcës punëtore të kualifikuar, angazhimin e pamjaftueshëm të komunitetit lokal,

kòordinimin e dobët midis grupeve të interesit dhe performancën e dobët të Agjencisë Kombëtare të Turizmit, ndër të tjera.

Intervistat me grupet e interesit kanë nxjerrë në pah sfida të përbashkëta të tilla si barrierat rregullatore, nevoja për përmirësime të infrastrukturës, vështirësitë në marrjen e financimit, nevoja kritike për formalizim dhe përmirësim të komunikimit dhe bashkëpunimit midis grupeve të sektorit publik dhe atyre të sektorit privat.

Në seksionin “Sistemi rregullator dhe i menaxhimit të turizmit” theksohet se ligjet dhe politikat ekzistuese që rregullojnë aktivitetet turistike po përballen me sfida të konsiderueshme që kanë të bëjnë me zbatimin dhe përshtatjen e tyre me kushtet aktuale të tregut. Kjo evidenton nevojën urgjente për të përditësuar dhe formalizuar kuadrin ligjor.

Gjetjet kryesore theksojnë gjithashtu sfidat operacionale brenda sistemit pothuajse joekzistent të Organizatave të Menaxhimit të Destinacioneve (OMD-ve) në vend.

Një pikë kryesore e këtij seksioni është roli i Agjencisë Kombëtare e Turizmit (AKT) ku konstatohet se efektiviteti i saj është i kufizuar për shkak të varësisë së saj nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në lidhje me buxhetin dhe drejtimin strategjik të saj dhe mungesën e një sistemi të konsoliduar për financimin e AKT-së.

Në seksionin “Përfundimet dhe rezultatet”, pas analizës së thelluar të kryer mbi sektorin e turizmit në Shqipëri, janë identifikuar sfidat kritike që frenojnë kapacitetin e sektorit për rritje të qëndrueshme dhe përmirësim të konkurrueshmërisë si më poshtë:

1. Lëvizshmëria e pafavorshme brenda dhe ndërmjet destinacioneve;
2. Nevoja për diversifikimin e opsioneve të aksesit ajror;
3. Diversifikimi i pamjaftueshëm i produkteve dhe eksperiencave turistike;
4. Mungesa e forcës punëtore të kualifikuar;
5. Sistemi jofunksional i menaxhimit të destinacioneve;
6. Kuadri rregullator i vjetruar që nuk ka zbatim;
7. Mungesa e një sistemi/qasjeje strategjike dhe operacionale marketingu;

8. Mungesa e mekanizmit zyrtar për koordinimin e grupeve të interesit.

Adresimi i këtyre sfidave përmes planifikimit strategjik, investimeve në infrastrukturë, reformave rregullatore, zhvillimit të forcës punëtore, prezantimit të sistemit të informacionit për menaxhimin e turizmit dhe angazhimit të grupeve të interesit është kritik për transformimin e sektorit të turizmit në Shqipëri gjatë viteve të ardhshme.

Kapitulli II- KUADRI STRATEGJIK

Në këtë kapitull janë përfshirë:

Në pikën 2.1 “Përcaktimi i skenarëve alternativë të zhvillimit”, janë formuluar dy skenarë të ndryshëm zhvillimi bazuar në supozime, duke projektuar rezultatet e zhvillimit të turizmit në vitin 2030, **skenari i Status quo-së dhe Skenarit të Zhvillimit të Qëndrueshëm**, duke u ndalur veçanërisht tek ky i fundit, si modeli që Shqipëria qartësisht ka zgjedhur për një zhvillim të ekuilibruar, bazuar në tre aspekte themelore siç janë ato mjedisore, sociale dhe ekonomike.

Gjithashtu është përshkruar metodologjia që për shkak të mungesës së informacionit të saktë për secilin tregues, shifrat referencë për të gjitha kategoritë janë përftuar nga një kombinim i burimeve të disponueshme, të dhënat nga studimet parësore dhe dytësore dhe ushtrimet krahasuese. Ky proces ka përfshirë krahasimin e të dhënave të disponueshme me tregjet e turizmit në faza të ngjashme zhvillimi për të garantuar saktësi dhe besueshmëri.

Në pikën 2.1.1 “Skenari i Status quo-së” konsiderohet që industria e turizmit në Shqipëri regjistron një shtrirje të modelit aktual, duke çuar kështu në zhvillim të pabalancuar në vend.

Nëse nuk ndërmerren ndërhyrje të konsiderueshme, ky sektor rrezikon të përballet me stanjacion ose rritje të kufizuar dhe rënie të konkurrencës në një periudhë afatmesme deri në afatgjatë.

Supozimet mbi të cilat mbështetet skenari i “Status quo-së” janë mjedisore, sociale dhe ekonomike.

Treguesit sasiore dhe rezultatet e këtij skenari, bazuar në supozimet pasqyrohen në formë tabelare. Tabela shtjellon faktorët sasiore, vlerëson statusin e tyre në vitin 2030 dhe eksploron lidhjen e tyre me vitin bazë të analizës, 2023.

Në pikën 2.1.2 Skenari i zhvillimit të qëndrueshëm, parashikohet skenari i cili ka një përpjekje të bashkërenduar drejt arritjes së një zhvillimi të ekuilibruar të turizmit në Shqipëri duke i dhënë përparësi qëndrueshmërisë pa e parë atë si pengesë për rritjen, duke mundësuar kështu shfaqjen e zgjidhjeve inovative. Në fokus është zhvillimi i sistemeve të forta për të mbështetur praktikën e qëndrueshme në mbarë industrinë. Zgjidhjet projektohen në mënyrë të paanshme me qëllim që të gjitha grupet e përfshira të interesit të përfitojnë prej tyre. Gjithashtu, ekziston angazhimi për zbatim të plotë dhe një qasje profesionale, çka garanton zbatimin e strategjive në mënyrë efektive dhe efikase si dhe zbatimin e reformave gjithëpërfshirëse, me një vëmendje të veçantë të rinovimit të kuadrit rregullator dhe përmirësimit të sistemit të menaxhimit të destinacioneve.

Supozimet e skenarit të dytë të shqyrtuar janë si në vijim:

Mjedisore:

- Kuadri legjislativ funksional rregullon ngritjen e kapaciteteve të reja akomoduese në Shqipëri, duke e vënë theksin te rritja e qëndrueshme, zhvillimi dhe mbrojtja e zonës në mënyrë inteligjente;
- Tregu i strukturave akomoduese me qira afatshkurtër zgjerohet në përputhje me direktivën, duke u fokusuar në minimizimin e ndikimeve negative mjedisore;
- Projektet e zhvillimit me përdorim të shumëfishtë zbatohen brenda kornizave rregullatore të përcaktuara në mënyrë të qartë;
- Infrastruktura turistike në zonat e mbrojtura po përmirësohet përmes investimeve të ndryshme, duke e vënë theksin te mbrojtja dhe rritja e qëndrueshme e zonës;

Sociale:

- Kurrikulat e arsimit në institucionet arsimore janë të përshtatura me tendencat e turizmit dhe nevojat e sektorit;
- Po zbatohen nisma dhe strategji për të mundësuar mbajtjen e forcës punëtore në sektorin e turizmit në Shqipëri;
- Kuadri legjislativ rregullon raportin midis strukturave akomoduese rezidenciale dhe atyre të hotelerisë për t'i sjellë përfitime sektorit të turizmit, si dhe popullsisë vendase;

- Po rritet mbështetja e publikut të gjerë për zhvillimin e mëtejshëm të turizmit;

Ekonomike/qeveritare:

- Po zbatohen strategji për të përmirësuar ndërlidhjen midis alternativave të transportit dhe lëvizshmërinë në Shqipëri, duke i dhënë përparësi përmirësimit të aksesueshmërisë rrugore, zgjerimit të rrugëve të transportit publik dhe integritimit efikas të zgjidhjeve moderne digjitale;
- Po zbatohen iniciativa për të tërhequr investimet, duke përmirësuar konkurrencën e burimeve ekzistuese për turizmin
- Zgjerimi i objektit të produkteve dhe eksperiencave turistike;
- Është miratuar një strategji gjithëpërfshirëse për aksesin ajror që mbështet rritjen e qëndrueshme të sektorit të turizmit;
- Është përcaktuar një model i ri i menaxhimit të destinacioneve që përfshin nivelet kombëtare, rajonale dhe lokale;
- Procesi i vazhdueshëm i zbatimit të sistemit të Organizatës së Menaxhimit të Destinacionit (OMD) i jep përparësi transparencës në ndarjen e përgjegjësi dhe roleve, bazuar në një kuadër ligjor të mirëpërcaktuar;
- Është në fuqi një model i qartë i rregullores për zhvillimin e resorteve të shfrytëzimit të miksuar, çka garanton qëndrueshmëri afatgjatë dhe rregulla bazë;
- Është në fuqi një sistem i ri taksimi për sektorin e turizmit, i cili mbështetet në shifra reale dhe në parimin e paanshmërisë, dhe jo në shifra të përafërta;
- Përdoret një platformë në kohë reale për regjistrimin e vizitorëve, e cila shfrytëzon teknologjinë për të integruar proceset e mbledhjes së të dhënave dhe për t'u dhënë akses të gjitha grupeve kryesore të interesit në të dhënat në kohë reale;
- Janë forcuar mekanizmat për garantimin e përputhshmërisë me rregulloret përmes masave të tilla si, kryerja e inspektimeve rutinë dhe vendosja e gjobave për shkeljet;
- Po miratohet një qasje për marketingun dhe planifikimin strategjik në sektorin e turizmit, duke e vënë theksin tek analitika, informacionet e mbështetura në të dhëna dhe vendosja e qëllimeve të qarta.

Në pikën 2.14 “Konkluzionet dhe implikimet kryesore” janë përshkruar dy skenarë të ndryshëm zhvillimi për sektorin e turizmit në Shqipëri dhe parashikoi rezultatet e tyre të mundshme deri në vitin 2030. Skenari i parë, ruajtja e status quo-së, parashikon një vazhdimësi të modelit aktual të zhvillimit të turizmit. Skenari i status quo-së thekson sfidat e zhvillimit të pabalancuar që rrjedhin nga mungesa e sistemeve dhe mbështetjes gjithëpërfshirëse, si dhe nga zbatimi i zgjidhjeve vetëm të pjesshme.

Nga ana tjetër, skenari i dytë propozon një model të rritjes së qëndrueshme që kushtëzohet nga reforma të rëndësishme në menaxhimin e turizmit. Skenari i zhvillimit të qëndrueshëm i jep përparësi qëndrueshmërisë afatgjatë, çka do të thotë se sektori i turizmit duhet t'i nënshtrohet disa ndryshimeve, ku përfshihen, zhvillimi i një kuadri të ri rregullator, ripërcaktimi i sistemit të menaxhimit të destinacioneve, përcaktimi i qartë i përgjegjësisë dhe miratimi i metodave të reja të menaxhimit për të monitoruar treguesit e performancës në mënyrë efektive.

Pas prezantimit strategjik të skenarëve, **iu dha përparësi zhvillimit të qëndrueshëm si e vetmja rrugë drejt progresit në të ardhmen.**

Në pikën 2.2.1 “Vizioni strategjik dhe pozicionimi”, përcaktohet vizioni i deklaruar:

“Shqipëria është destinacioni i ri më emocionues në Europë, që ofron vlerën më të mirë të bazuar në aspektin e cilësisë, gjithëpërfshirjes dhe qëndrueshmërisë”.

Bazat e Vizionit 2030 janë përcaktuar: Destinacioni më emocionues dhe i ri në Evropë; Raporti më i mirë kosto-përfitim; Cilësia; Gjithëpërfshirja dhe Qëndrueshmëria.

Në pikën 2.2.2 “Pozicionimi”, është përcaktuar, në përputhje me vizionin, pozicionimi përkatës në treg, i cili synon të ndërtojë imazhin e dëshiruar në tregun e turizmit, si dhe në sytë e turistëve dhe partnerëve të biznesit, brenda vitit 2030.

Deklarata e pozicionimit: Shqipëria me peizazhet e saj natyrore të mrekullueshme, pasurinë e larmishme kulturore dhe banorët mikpritës, ofron një raport të pakrahasueshëm kosto-përfitim. Shqipëria plotëson dëshirat e larmishme të vizitorëve, si të atyre që udhëtojnë për qëllime biznesi, ashtu dhe të atyre që udhëtojnë për qëllime dëfrimi, duke i dhënë përparësi

qëndrueshmërisë për të garantuar një eksport cilësor, autentik dhe të përgjegjshëm që tejkalon vazhdimisht pritshmëritë.

Slogani: Shqipëria – jo vetëm një destinacion, por një zbulim.

Në pikën 2.3 janë përcaktuar Synimet e Rritjes, pas identifikimit të skenarit të zhvillimit që përputhet me vizionin dhe pozicionimin e Shqipërisë. Ky skenar shërbeu si bazë për vendosjen e synimeve sasiore (numerike) dhe cilësore (përshkruese) të rritjes, duke përcaktuar treguesit kryesorë më të rëndësishëm që Shqipëria synon të arrijë deri në vitin 2030.

Në pikën 2.3.1 Synimet sasiore të rritjes, janë parashikuar synimet synimet sasiore (numerike) si më poshtë:

- **Oferta e turizmit**

Numri i shtretërve është rritur në mënyrë të vazhdueshme në rreth 270.000 në vitin 2023 dhe kapaciteti total i shtretërve parashikohet të rritet në 477.414 shtretër brenda shtatë vitesh;

Kontrolli më i rreptë i strukturave akomoduese me qira afatshkurtër dhe rregullimi më i mirë i zhvillimeve të reja në fushën e hotelërisë, si resortet e shfrytëzimit të miksuar, do të mundësojnë një rritje më të shpejtë të kapaciteteve hoteliere. Nga ana tjetër, numri i shtretërve në strukturat akomoduese me qira afatshkurtër parashikohet të rritet me një normë më të ngadaltë.

Deri në vitin 2030, kapaciteti i shtretërve në hotele pritet të rritet në masën 28% të tregut ndërsa në vitin 2023 kjo shifër ishte përllogaritur në rreth 22%. Në krahun tjetër, strukturat akomoduese me qira afatshkurtër dhe kategoritë e tjera do të regjistrojnë rënie të pjesës së tregut, përkatësisht 61% dhe 12%, nga 65% dhe 13%.

- **Kërkesa për turizëm**

Vlerësohet se në vitin 2030 numri i turistëve që do të mbërrijnë, të regjistruar për qëllim turistik, do të rritet në 9,8 milionë, ndërsa netë-qëndrimet në strukturat akomoduese tregtare do të arrijnë në 58,4 milionë.

Gjithashtu, diversifikimi i motiveve të ardhjes në Shqipëri, i shoqëruar nga zhvillimi i mëtejshëm i produkteve dhe eksperiencave turistike, do të zvogëlojë përqindjen e netë-qëndrimeve gjatë sezonit të pikut veror (qershor – shtator). Parashikohet që deri në vitin 2030, netë-qëndrimet jashtë sezonit të pikut do të përbëjnë afërsisht 35% të totalit të netë-qëndrimeve të regjistruara.

Norma aktuale mesatare vjetore e shfrytëzueshmërisë së shtretërve në të gjitha strukturat akomoduese është afërsisht 21%. Me rritjen e kërkesës, zhvillimin e vazhdueshëm të produkteve dhe eksperiencave turistike gjatë gjithë vitit dhe përmirësimin e ofertës së turizmit, parashikohet që shfrytëzueshmëria mesatare vjetore e shtretërve do të rritet në 34% deri në vitin 2030.

Kohëzgjatja mesatare aktuale e qëndrimit vlerësohet të jetë 4,8 netë. Falë një game më tërheqëse dhe konkurruese të produkteve dhe eksperiencave turistike që synojnë inkurajimin e qëndrimeve më të gjata, si dhe falë krijimit të motiveve të reja për të vizituar vendin, kohëzgjatja mesatare e qëndrimit pritet të rritet në 6,0 netë.

- **Të ardhurat nga taksat**

Aktualisht vlerësohet se të ardhurat totale nga taksa e fjetjes janë afërsisht 21,6 milionë euro. Me zbatimin e një sistemi të rishikuar të mbledhjes së taksës së turizmit, duke përfshirë një taksë të sheshtë, parashikohet që të ardhurat totale nga taksa e turizmit të arrijnë në 85,1 milionë euro deri në vitin 2030.

- **Punësimi dhe arsimit**

Ministria e Arsimit dhe Sportit raporton se ka 2900 studentë të regjistruar në programet e hoteleri-turizmit në shkollat publike profesionale dhe 2312 studentë që ndjekin studime të ngjashme në institucionet e arsimit të lartë. Planet për përmirësimin e kurrikulës synojnë të harmonizojnë më mirë këto programe arsimore me kërkesat aktuale të sektorit të turizmit. Parashikohet se këto përmirësime do të rrisin numrin total të studentëve në shkollat publike profesionale, përkatësisht në 4687 studentë, si dhe të studentëve në institucionet e arsimit të lartë, përkatësisht në 3810 studentë;

Në vitin 2023, INSTAT raportoi se kishte 42 698 individë të punësuar në sektorin e turizmit. Nisur nga rritja e kërkesës për shërbime turistike, rritja e numrit të studentëve që ndjekin arsimin për hoteleri-turizëm, si dhe dëshira në rritje për të punuar në këtë sektor, parashikohet që deri në vitin 2030, numri i të punësuarve në industrinë e turizmit në Shqipëri do të arrijë në 73 778 persona, duke reflektuar një rritje të përgjithshme të sektorit të turizmit.

- **Të ardhurat nga turizmi**

Bazuar në të dhënat e Bankës së Shqipërisë, totali i të ardhurave nga turizmi për vitin 2023 është përlogaritur në 4,16 miliardë euro. Kjo shifër, bazuar rritjes së

kërkesës dhe në përputhje me tendencat më të gjera globale të udhëtimit, deri në vitin 2030 pritet të arrijë në 6,7 miliardë euro.

Në pikën 2.1.1 Synimet cilësore të rritjes përveç synimeve sasiore, janë përcaktuar objektiva cilësor të detajuar që synojnë zhvillimin e sektorit të turizmit të Shqipërisë deri në vitin 2030. Këto objektiva e vënë theksin te cilësia dhe natyra e rezultateve, duke shkuar përtej numrave. Fokusi është te praktikatat e qëndrueshme, ofertat krijuese dhe strategjitë gjithëpërfshirëse që do të rrisin avantazhin konkurrues të sektorit të turizmit në Shqipëri.

Synimet cilësore (përshkruese) të rritjes, për të përcaktuar treguesit kryesorë më të rëndësishëm që Shqipëria synon të arrijë deri në vitin 2030, janë parashikuar si më poshtë:

- **Prezantimi i produkteve dhe përvojave të reja**

Ky synim fokusohet në një shpërndarje më të barabartë të përfitimeve ekonomike nga turizmi në stinë dhe vendndodhje të ndryshme, duke rritur ndjeshëm qëndrueshmërinë e sektorit të turizmit, nëpërmjet diversifikimit të ofertave të turizmit përtej produkteve tradicionale të diellit dhe plazhit, duke përfshirë përvoja që tërheqin vizitorët gjatë gjithë vitit, përmbushin interesa të ndryshme dhe inkurajojnë qëndrime më të gjata, si p.sh., turizmi kulturor, detar, aktiv në natyrë, pushimi në qytet etj..

- **Objektivi i rritjes së ndërgjegjësimit mbi markën kombëtare**

Nëpërmjet tij synohet forcimi i imazhit të Shqipërisë duke i dhënë një pamje të re markës së turizmit për të pasqyruar atributet unike dhe vlerat identifikuese të vendit, me synimin për ta pozicionuar Shqipërinë si një markë të paharrueshme dhe të vlerësuar në tregun ndërkombëtar të turizmit deri në vitin 2030.

- **Përmirësimi i kuadrit rregullator**

Përmirësimi i kuadrit ligjor kërkon një përpjekje të posaçme dhe të vazhdueshme për t'i zbatuar reformat në mënyrë efektive. Qëllimi është të luftohen problematika të tilla si ekonomia informale, mungesa e transparencës dhe trajtimi i padrejtë i grupeve të interesit në sektorin e turizmit, standardizimi i veprimtarive turistike, etj..

- **Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të destinacioneve**

Deri me 2030 synohet të krijohet një strukturë organizative më konkurruese dhe efikase në sistemin e Organizatës së Menaxhimit të Destinacionit (OMD), duke u fokusuar në një ndarje efektive të përgjegjësisë dhe proceseve organizative në të gjitha nivelet - kombëtare, rajonale dhe lokale.

- **Përmirësimi i sistemit të marketingut të destinacioneve**

Krijimi i një kuadri marketingu praktik dhe proaktiv që mundëson zhvillimin e përmbytjeve inovative dhe promovimin me sukses të Shqipërisë në skenën e turizmit ndërkombëtar nëpërmjet një strategjie të re marketingu.

- **Valorizimi i qëndrueshëm i burimeve kulturore dhe natyrore**

Synohet të përmirësojë atraksionet ekzistuese turistike, duke u fokusuar veçanërisht në atraksionet natyrore dhe kulturore të pashfrytëzuara përtej zonave bregdetare. Kjo përfshin miratimin e një qasjeje të mbrojtjes në mënyrë inteligjente që përpiket të arrijë një ekuilibër midis aspekteve të qëndrueshmërisë ekonomike, sociale dhe mjedisore.

- **Shfrytëzimi strategjik i hapësirës për të nxitur zgjerimin e qëndrueshëm të turizmit**

Ky synim përfshin planifikimin dhe menaxhimin e kujdesshëm të projekteve të reja zhvillimore për të garantuar që rritja e turizmit të shoqërohet nga aspektet e qëndrueshmërisë mjedisore, realizueshmërisë ekonomike dhe barazisë sociale. Kjo qasje synon të shpërndajë aktivitetet turistike dhe projektet e reja në mënyrë më të barabartë nëpër rajone, duke reduktuar presionin në zonat e mbivizituara, si dhe duke përmirësuar përvojën e vizitorëve duke ruajtur në të njëjtën kohë burimet natyrore dhe kulturore.

- **Bashkëpunimi ndërsektorial**

Kjo qasje fokusohet veçanërisht në bashkëpunimin me ministri të ndryshme të qeverisë për të hartuar një strategji të unifikuar për zhvillimin e turizmit. Duke vepruar në këtë mënyrë, mundësohet përdorimi i një game të gjerë burimesh dhe ekspertize.

- **Rritja e gjithëpërfshirjes, aksesueshmërisë dhe diversitetit**

Kjo qasje fokusohet në krijimin e një tabloje turistike më të barabartë dhe të larmishme që përqafon dallimet dhe ofron përvoja përmbytëse për një audiencë më të gjerë.

Në pikën 2.4 “Klasterizimi i turizmit dhe produktet parësore turistike” janë identifikuar zonat më të mëdha gjeografike që kanë disa veçori të përbashkëta (në lidhje me përvojën, gjeo-morfologjinë etj.), në të cilat janë të përqendruara ose duhet të zhvillohen në të ardhmen, një sërë produktesh, aktivitetsesh, eksperiencash, atraksionesh dhe infrastrukturash turistike të krahasueshme ose të ngjashme. Për këtë arsye, janë identifikuar gjashtë klastera të turizmit:

1. Klasteri i bregdetit të Adriatikut

Ky klaster përfshin të gjithë zonën e bregdetit verior të Shqipërisë dhe shtrihet nga kufiri i vendit me Malin e Zi në veri, deri në grykëderdhjen e lumit Vjosa në pjesën qendrore të vendit, si dhe përfshin zonat bregdetare të disa qarqeve: Shkodër, Lezhë, Tiranë, Durrës dhe Fier. Ky klaster ofron një qasje turistike shumëdimensionale pasi përfshin një shumëllojshmëri peizazhesh, duke ofruar një përvojë gjithëpërfshirëse të bregdetit të Adriatikut në Shqipëri dhe në të njëjtën kohë, duke inkurajuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të turizmit.

2. Klasteri verior i brendshëm

Klasteri verior i brendshëm i turizmit ndodhet në pjesën veriperëndimore të Shqipërisë dhe përfshin qarqet e Kukësit dhe Dibrës në tërësinë e tyre, së bashku me zonat e brendshme të qarkut të Shkodrës. Gjeografia e këtij klasteri është e larmishme, e karakterizuar nga Alpet Shqiptare në veri, liqeni i Shkodrës dhe malësitë piktoreske të qarqeve të Kukësit dhe Dibrës, që jo vetëm përmbush kërkesat e të apasionuarve pas aventurave në natyrë, por gjithashtu shfaq trashëgiminë autentike rurale dhe kulturore të Shqipërisë.

3. Klasteri i qytetit të Tiranës

Koncepti i Tiranës si një klaster apo destinacion pushimi në qytet përqendrohet në idenë e ofrimit të një eksperience kompakte, por të larmishme, që kombinon avantazhet e turizmit urban me eksplorimin e trashëgimisë dhe aventurat në natyrë. Kjo qasje e shumanshme synon ta pozicionojë Tiranën jo vetëm si kryeqytetin e Shqipërisë, por edhe si një destinacion të pavarur pushimi në qytet që përmbush një gamë të gjerë interesash dhe përvojash.

4. Klasteri qendror

Përfshin qarkun e Elbasanit dhe rajonet e brendshme rurale të qarkut të Tiranës, me përjashtim të qytetit të Tiranës. Krahas gamës së gjerë të përvojave në këtë klaster si ecja në natyrë, trekking, eksplorimi i kanioneve, rafting dhe hedhje me parashutë, muzetë etj., klasteri ofron një tablo unike të jetës rurale dhe u mundëson vizitorëve të qëndrojnë në bujtinat rurale, si dhe të angazhohen në kurset e gatimit tradicional dhe veprimtaritë bujqësore, duke pasuruar përvojën e tyre të udhëtimit me vizita edukative, shëtitje në natyrë dhe degustime të prodhimeve vendase si vera dhe vaji i ullirit.

5. Klasteri i bregdetit të Jonit

Përfshin të gjithë qarkun e Vlorës (zonat bregdetare dhe ato në brendësi të territorit) dhe është përcaktuar në veçanti për shkak të eksperiencave dhe produkteve turistike të njëtrajtshme që ofron në të gjithë zonën e tij. Kryesisht, ky klaster karakterizohet nga turizmi i diellit dhe plazhit, por ofron gjithashtu një përvojë të fortë kulturore dhe gastronomike.

6. Klasteri jugor i brendshëm

Përfshin qarqet e Beratit, Gjirokastrës dhe Korçës. Përcaktimi i kufijve të këtij klasteri është bazuar në trashëgiminë e pasur kulturore dhe bukurinë natyrore të zonës, pasi në territorin e tij ndodhen një sërë sitesh që janë pjesë e listës së UNESCO-s. Për më tepër, ai shërben si një qendër për eksplorimin e natyrës dhe aventurat në natyrë, me peizazhe të larmishme që ofrojnë mundësi për rafting, ecje në natyrë dhe eksplorim të fshatrave tradicionale, si dhe promovon turizmin eno-gastronomik falë vreshtarive të zonës, traditave të kuzhinës vendase, degustimit të verërave dhe kurseve të gatimit, me theks të veçantë te prodhimet dhe kuzhina vendase.

Krahas identifikimit të klasterave të turizmit, është bërë gjithashtu përcaktimi i një grupi gjithëpërfshirës variablash për çdo klaster të identifikuar, të cilët ofrojnë një pamje të përgjithshme dhe cilësitë e detajuara të secilit klaster, duke përfshirë aspektet thelbësore si produktet turistike parësore dhe dytësore, burimet dhe atraksionet kyçe, si dhe përvojat kryesore të disponueshme për turistët.

Strategjia kombëtare e Turizmit integron parimet e qëndrueshmërisë në të gjitha fushat prioritare duke siguruar një qasje gjithëpërfshirëse për zhvillimin e sektorit të turizmit në Shqipëri.

Në pikën 2.5 “Identifikimi i prioriteteve të zhvillimit” janë përcaktuar 6 prioritete kyçe të zhvillimit në të cilat bazohet kjo strategji dhe që janë thelbësore për zhvillimin e mëtejshëm të suksesshëm dhe të ekuilibruar të turizmit në Shqipëri.

1. *Investimet*, ku synohet të tërhiqen investime që sigurojnë përfitime afatgjata për të gjithë sektorin e turizmit dhe komunitetet vendase. Objektivat kryesorë të këtij prioriteti të zhvillimit përfshijnë:
 - Zbatimin e një game të stimuljeve fiskale, mekanizmave mbështetës dhe skemave të përshtatura të investimeve për të tërhequr

investitorët vendas dhe ndërkombëtarë në projektet strategjike të turizmit.

- Zbatimin e masave dhe zhvillimeve që synojnë uljen e barrierave ndaj investimeve, si thjeshtimin e proceseve komplekse administrative dhe ofrimin e njohurive të vlefshme për tregun e turizmit, nëpërmjet stimuljeve jofiskalë.
- Përzgjedhja dhe përcaktimi i kujdesshëm i zonave specifike për zhvillimin e turizmit, me qëllim kanalizimin e investimeve drejt zonave me potencialin më të lartë për rritje dhe me interesin më të lartë strategjik në vend.
- Ofrimi i mbështetjes thelbësore për ndërmarrjet turistike mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM), duke alokuar burime për përmirësimin e produkteve dhe të përvojës, si dhe për zhvillimin më të gjerë të këtyre ndërmarrjeve.
- Sigurimi i aksesit në opsione më të favorshme financimi për projektet strategjike turistike dhe infrastrukturën përkatëse.

2. *Politika rregullatore dhe fiskale e turizmit*, është i nevojshëm një kuadër i përditësuar, i cili nuk duhet të trajtojë vetëm sfidat bashkëkohore, si përdorimi i platformave të rezervimit dhe kërkesa për të dhënat e tregut në kohë reale, por duhet të trajtojë gjithashtu edhe mangësitë aktuale. Objektivat kryesorë të këtij prioriteti të zhvillimit përfshijnë:

- Përmirësimi i sistemit të taksimit për sektorin e turizmit, me fokus në minimizimin e humbjeve aktuale të të ardhurave nga tatimet.
- Përmirësimi i skemave të nxitjes së investimeve. Një mjedis rregullator transparent dhe efikas është thelbësor për tërheqjen e investimeve në sektorin e turizmit, duke përfshirë ndërtimin e hoteleve, resorteve dhe infrastrukturave të tjera turistike.
- Kategorizimi i strukturave akomoduese ekzistuese dhe të reja. Përmirësimi i rregulloreve për përcaktimin dhe zbatimin e standardeve të cilësisë dhe sigurisë është thelbësor për mbrojtjen e turistëve dhe përmirësimin e përvojave të tyre.
- Rregullimi i ndërtimit të strukturave akomoduese me qira afatshkurtër dhe hoteleve të reja.
- Krijimi i një kuadri ligjor që përcakton standardet minimale të shërbimit dhe që qartëson detyrimet dhe të drejtat e ofruesve të

shërbimeve turistike dhe të konsumatorëve, është thelbësor për të garantuar transparencë dhe cilësi në të gjithë industrinë e turizmit.

3. *Menaxhimi i destinacioneve* për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të turizmit që redukton efektet negative në mjedis dhe komunitetet vendase. Objektivat kryesorë të këtij prioriteti janë:

- Njohjen e roleve dhe përgjegjësi specifike në nivelet kombëtare, rajonale dhe lokale.
- Krijimin e një kuadri ligjor koherent që përshkruan qartë përgjegjësitë, duke u siguruar që çdo nivel menaxhimi të punojë drejt objektivave të përbashkëta.
- Identifikimin e një mekanizmi të qëndrueshëm financimi që përputhet me performancën turistike të vendit.
- Ngritjen e një sistemi informacioni për menaxhimin e turizmit, i cili duhet të mbledhë dhe të analizojë të dhëna në kohë reale, për të mundësuar një qasje të bazuar në njohuri për menaxhimin e destinacioneve.

4. *Zhvillimi i produkteve turistike*. Përmirësimi i konkurrueshmërisë së ofertës turistike të Shqipërisë duhet të fokusohet në:

- Vënien e theksit të raporti i shkëlqyer kosto-përfitim, duke u bazuar në ofrimin e një cilësie dhe vlere të jashtëzakonshme që garanton një kosto-efektive më të lartë në krahasim me vendet e tjera në rajon dhe Evropë.
- Ofrimin e produkteve dhe eksperiencave tërheqëse turistike gjatë gjithë vitit. Hapja e parashikuar e një aeroporti tjetër në Shqipëri ofron mundësi të reja për një shpërndarje më të barabartë të turizmit gjatë gjithë vitit dhe në rajone të ndryshme.
- Njohjen e rolit thelbësor të kompanive të menaxhimit të destinacioneve (KMD) në krijimin e eksperiencave turistike inovative dhe unike që përbëjnë themelin e sektorit të turizmit në zhvillim në Shqipëri.
- Krijimin e përvojave përmes një modeli inovativ të rritjes së vlerës, me synimin për t'i bërë ofertat turistike të Shqipërisë konkurruese dhe unike, duke i bërë kështu tërheqëse për një gamë më të gjerë të preferencave të turistëve.

- Njohjen e rolit kritik të angazhimit të komunitetit. Përfshirja e turizmit të bazuar në komunitet dhe promovimi i aktiviteteve që përfshijnë çdo gjini mund të përmirësojë barazinë e përfitimeve ekonomike.
5. *Marketingu i destinacioneve.* Objektivat kryesorë të këtij prioriteti të zhvillimit përfshijnë:
- Qasje metodike ndaj planifikimit, projektimit, zbatimit dhe vlerësimit të aktiviteteve të marketingut për të siguruar arritjen e suksesit.
 - Përcaktimin e roleve dhe përgjegjësi të qarta për të gjitha grupet e interesit të përfshira në veprimtaritë e marketingut në sektorin e turizmit.
 - Strategji gjithëpërfshirëse e marketingut që përshkruan elementet thelbësore si tregjet e burimeve të synuara, segmentet e tregut, kanalet e komunikimit, objektivat, nismat specifike dhe alokimet buxhetore.
 - Zhvillimi dhe menaxhimi i markës së turizmit të Shqipërisë. Kjo përfshin krijimin dhe promovimin e nënmarkave që theksojnë atributet unike të destinacioneve dhe produkteve individuale, duke rritur kështu vizibilitetin dhe atraktivitetin e tyre.
6. *Ngritja e kapaciteteve.* Përfshin kapacitetet e brendshme dhe të jashtme. Ky përmirësim duhet të përfshijë:
- Përparime në arsimin formal duke u siguruar që kurrikulat në universitete, shkolla profesionale publike dhe institucione të tjera arsimore të pasqyrojnë tendencat më të fundit të tregut dhe nevojat specifike të industrisë së turizmit.
 - Investimet e konsiderueshme në arsimin joformal. Grupet e interesit në të gjithë sektorët e biznesit dhe ato publikë duhet të kenë akses në një gamë të gjerë të mundësive të të nxënit, ku përfshihen seminarët, seancat e trajnimit, prezantimet, programet e certifikimit, si dhe zhvillimi i platformave digjitale dhe mësimdhënia në akademi.
 - Nxitjen e përfshirjes, veçanërisht duke inkurajuar, pjesëmarrjen e grave në nismat e turizmit.

Kapitulli III- STRATEGJITË E ZHVILLIMIT

Pjesa e tretë e Draft-Strategjisë i referohet Strategjive të Zhvillimit, të cilat shtjellohen bazuar në gjashtë fushat prioritare.

Për secilën prej masave zhvillimore të parashikuara në planin e veprimit të strategjisë, si dhe në përputhje me 6 fushat prioritare të identifikuara, janë shtjelluar komponentët si:

- Koncepti, i cili trajton në mënyrë të përgjithshme fokusin e çdo mase zhvillimore.
- Veçoritë kryesore, në të cilat identifikohen rekomandime, bashkëpunime të ndryshme etj., të rëndësishme për zhvillimin e masave.
- Subjekti përgjegjës për zbatimin, përcakton institucionet direkt përgjegjëse për zbatimin e masave, si dhe institucionet mbështetëse.
- Hapat e zbatimit, parashikon detajimin e masave në nënaktivitete.

Këto masa zhvillimore janë hartuar për të trajtuar dhe zgjidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë sfidat e identifikuara më parë me të cilat përballet sektori i turizmit në Shqipëri.

Kontributi në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ)

Strategjia Kombëtare e Turizmit është hartuar në përputhje me tre shtyllat e qëndrueshmërisë: sociale, mjedisore dhe ekonomike. Ky harmonizim ka garantuar se çdo masë zhvillimore mbështet përmbushjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ).

Në formë tabelare paraqitet ndikimi i masave zhvillimore në OZHQ-të përkatëse. Më pas, çdo iniciativë zhvillimore e propozuar është vlerësuar për të përcaktuar ndikimin e saj në këto OZHQ përkatëse dhe ndikimet janë kategorizuar si të ulëta, mesatare ose të larta. Këto ndikime përfaqësohen vizualisht përmes nuancave të ngjyrës së gjelbër: përkatësisht, ngjyra e gjelbër e errët tregon një ndikim të fortë, ndërsa ngjyra e gjelbër e hapur tregon një kontribut më të ulët.

Bashkëngjitur Strategjisë ndodhet në formë tabelare, Plani i Veprimit 'i Dokumentit Strategjik, në të cilin përfshihen të gjithë fushat kryesore dhe masat strategjike për çdo masa zhvillimore. Aty përfshihen afatet përkatëse për realizimin e masave, burimet financiare, strukturat përgjegjëse për realizimin e tyre, treguesit e matshëm, si dhe nevojat e mundshme për projekte.

Përcaktimi i masave zhvillimore, treguesit sasiorë dhe cilësorë të zbatimit, afatit kohor dhe strukturat përgjegjëse, janë drejtimet kryesore për krijimin e kornizës së llogaridhënies.

Draft strategjia e zhvillimit të turizmit 2025 - 2030 është një dokument që do të orientojë jo vetëm zbatimin e politikave turistike, por edhe Projekt-Buxhetin për turizmin deri në vitin 2030.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Për hartimin e këtij projektvendimi kanë kontribuar, Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Turizmit, Sektori i Programimit, Hartimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore, në Drejtorinë e Programimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator pranë Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Turizëm dhe Mjedis.

Drafti i Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit u realizua me mbështetjen e Organizatës Gjermane për Bashkëpunim Teknik në Shqipëri (GIZ) dhe ekspertët ndërkombëtar të kompanisë Horëath Consulting HTL, si dhe specialistë të turizmit pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit duke u konsultuar me grupet e interesit.

Në fazën e parë të hartimit të draftit të strategjisë, në zbatim të urdhrat të Kryeministrit nr. 93, datë 1.8.2023, "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit 2024-2030 dhe monitorimin e zbatimit të saj", draft Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit 2024-2030, është dërguar për mendim nëpërmjet postës elektronike grupit ndërinstitucional të punës të ngritur me përfaqësues nga institucionet: Ministria e Financave, Ministria e Brendshme, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Arsimit dhe Sportit Ministria së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Agjencia Kombëtare e Turizmit, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

Referuar sa më sipër, Ministria e Arsimit dhe Sportit sugjeron që në pikën 6.1 "Përmirësimi i arsimit formal" ku parashikohet përmirësimi dhe përditësimi i kurrikulës së arsimit profesional si dhe ngritja e qendrave rajonale të kompetencës, të cilat janë pjesë e fushës së përgjegjësisë së Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), MAS të jetë institucion përgjegjës së bashku me MEKI.

Disa sugjerime të përcjella nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit përfshijnë:

- Tek aktivitetet e strategjisë në lidhje me politikat e investimeve, për të cilat është vendosur AIDA si institucion lider, të mbahet në konsideratë që Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit është institucioni përgjegjës për politikat e investimeve, të cilat zbatohen edhe nga AIDA si agjenci zbatuese.
- Implementimi i rregullave të aktiviteteve turistike të mos bihen ndesh me Direktivën 2006/123/KE "Për Shërbimet në Tregun e Brendshëm" dhe të jenë në përputhje të plotë me ligjin nr. 66/2016 "Për Shërbimet në Republikën e Shqipërisë", ligj i cili përafron këtë direktivë.
- Të përfshihen masa dhe për mbështetjen e SME-ve në këtë sektor me qëllim zhvillimin e tyre dhe kapaciteteve njerëzore, për të rritur cilësinë e shërbimeve që ofrohen.

- Sugjerojmë se në strategjinë e zhvillimit të turizmit 2024-2030, është e nevojshme përfshirja e një mase të lidhur me krijimin e një plani të menaxhimit të kapaciteteve dhe strukturave akomoduese, sidomos në sezonet me flukse të larta turistike. Një masë e tillë do të ndikonte në mënyrë direkte në misionin dhe vizionin për Turizëm Cilësor dhe ofrimin e shërbimit turistik cilësor. Kjo e fundit është lidhur edhe me një nga rekomandimet e lëna në takimin Bilateral me Komisionin Evropian për kapitullin 20.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme sugjeron marrjen në konsideratë të korpusit të saj diplomatik si bashkëpunëtoare, mbështetëse dhe koordinuese tek zbatimi i pikës 3 të Strategjisë së Zhvillimit dhe Nxitjes së Investimeve në turizëm.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural sugjeron se sa i takon turizmit rural, është e rëndësishme që turizmi rural të planifikohet dhe menaxhohet në mënyrë që të ruajë burimet për brezat e ardhshëm, pasi rritja dhe zgjerimi i turizmit rural në terma afatgjatë mund të sjellë me vete rrezikun e komercializimit të kulturave lokale. Turizmi rural mund të jetë një burim i qëndrueshëm ekonomik, por është thelbësore që të balancohet zhvillimi me ruajtjen e integritetit të mjedisit dhe kulturës lokale.

Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB) bën me dije se dokumenti përshkruan një qasje të balancuar dhe të qëndrueshme për zhvillimin e turizmit, me një fokus të vecantë në cilësinë e shërbimit, ruajtjen e mjedisit, dhe rritjen e numrit të vizitorëve. Zbatimi i praktikave të qëndrueshme dhe menaxhimi efektiv i burimeve janë kyçe për të siguruar që turizmi të vazhdojë të jetë një kontribuues i rëndësishëm për ekonominë e vendit, pa ndikuar negativisht në mjedis.

Sa më sipër, sugjerimet dhe komentet e përcjella në rrugë elektronike, janë marrë në konsideratë dhe është kryer reflektimi i propozimeve në dokumentin strategjik.

Gjithashtu, draftstrategjia dhe plani i veprimit është konsultuar me Departamentin e Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri, e cila është

shprehur se në dokumentin e rishikuar të strategjisë së turizmit, konstatohet se janë reflektuar komentet në lidhje me sigurimin e përputhshmërisë në të gjithë dokumentin e përcaktimit të objektivave dhe në këtë aspekt janë të ndërthurura 4 qëllimet strategjike me objektivat e politikës dhe objektivat specifike, duke përcaktuar gjithashtu në tabelën nr. 11, “Matrica e Vlerësimit të Performancës”, për çdo indikator qëllimet strategjike që përmbushen. Është realizuar sugjerimi në lidhje me kostimin dhe buxhetimin, duke e lidhur dokumentin strategjik me Planin Afatmesëm Buxhetor, reflektuar në Planin e Veprimit dhe në tabelën nr. 10 të dokumentit strategjik si dhe duke përcaktuar qartë programin buxhetor në të cilin është mbështetur.

Përgjatë procesit të përgatitjes së Strategjisë, janë mbajtur në konsideratë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm në kuadër të Agjendës për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2030, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, në Shtator 2015, sa lidhet me reduktimin e varfërisë, rritjen e mirëqenies, rritjen ekonomike, edukimin, barazinë gjinore, zhvillimin lokal etj.

Procesi i konsultimit të draft Strategjisë me palët e interesuara

Dokumenti i draft Strategjisë është publikuar në datë 14.10.2024 në faqen zyrtare të konsultimit publik dhe ka qëndruar i publikuar deri në datën 11.11.2024. Gjatë periudhës së publikimit të dokumentit kanë ardhur komente nga palët e interesit si më poshtë:

1. Dhoma Amerikane e Tregtisë
2. Unioni Turistik Shqiptar
3. Shpresim Domi, lektor UBT
4. UN Women
5. RISI Albania, Mirtjon Mita

Lidhur me komentet e grupeve të interesit, përcjellë nëpërmjet faqes zyrtare të konsultimit publik, bëjmë me dije se janë evidentuar dhe shpjeguar në mënyrë të detajuar në Raportin Individual për rezultatet e konsultimit publik.

Gjithashtu, drafti është konsultuar me palët e interesit, si dhe ka kaluar në diskutim me përfaqësuesit e Njësitëve të Vetëqeverisjes Vendore, përfaqësuesit e subjekteve që ushtrojnë veprimtari turistike dhe me organizatat ndërkombëtare

në Shqipëri që bashkëpunojnë në fushën e turizmit. Konkretisht, janë organizuar 5 takime në disa rajone të vendit, me përfaqësues të pushtetit lokal, komunitetit të biznesit, organizatat ndërkombëtare, akademia dhe aktorë të tjerë, me prezencën edhe të partnerëve të GIZ në hartimin e strategjisë dhe ekspertëve të kompanisë Horëath, sipas kalendarit të mëposhtëm:

1. Takim i zhvilluar në datën 25 Tetor 2024 në bashkinë Korçë
2. Takim i zhvilluar në datën 30 Tetor 2024 në bashkinë Dibër
3. Takim i zhvilluar në datën 07 Nëntor 2024 në bashkinë Shkodër
4. Takim i zhvilluar në datën 15 Nëntor 2024 në bashkinë Vlorë dhe
5. Takim i zhvilluar në datën 18 Nëntor 2024 në Tiranë.

Në vijim, me qëllim konkludimin e fazës përfundimtare projektvendimi do të dërgohet për mendim pranë ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera, konkretisht: Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Agjencisë Shtetërore së Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Agjencisë Kombëtare së Shoqërisë së Informacionit, Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, Agjencisë Kombëtare së Planifikimit të Territorit, Bankës së Shqipërisë, Institutit të Statistikave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Autoritetit të Aviacionit Civil.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Kostoja për realizimin e planit të veprimit të kësaj Strategjie është e bazuar kryesisht në Programet e Buxhetit Afatmesëm për periudhën 2019-2021 dhe parashikimet për vitet 2022-2023.

Buxheti i përgjithshëm i planit të veprimit të strategjisë është sipas tabelës më poshtë:

Kosto totale (000 lekë)	Financim brendshëm (000 lekë)	Financim i huaj (000 lekë)	Hendeku (000 lekë)
1,829,840	1,424,146	221,473	184,220

Në lidhje me hendekun e krijuar ndërmjet koston totale të aktiviteteve të planifikuara dhe financimit nga buxheti, mendohet të kërkohet mbështetje nga donatorë.

Në rast se nuk do të arrihet sigurimi i fondeve të nevojshme, do të vijohet me realizimin e pjesshëm në varësi të buxhetit të siguruar.

Konkretisht:

Është parashikuar organizimi i tetë konferencave për tërheqjen e investorëve për të cilat buxheti në dispozicion mbulon vetëm katër prej tyre. Realizimi i katër konferencave të tjera do të jetë në varësi të sigurimit të buxhetit shtesë.

MINISTRI I TURIZMIT DHE MJEDISIT

Mirela KUMBARO FURXHI



